



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 45, datë 05.06.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT LUAN DERVISHI NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare/Relatore
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **zonjës Mimoza Arbri**, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës 05.06.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI PËR GJYQATAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: **Zoti Luan Dervishi**

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të zotit Luan Dervishi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **zonjës Arta Marku**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, **zonja Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Sokol Berberi.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe zoti Luan Dervishi.
4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku.
7. Ka rezultuar se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me Vendimin nr. 83, datë 26.11.2018 ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.”.
8. Kundër vendimit nr. 83, datë 26.11.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit kalimtar zoti Luan Dervishi.
9. Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk e ka shqyrtuar çështjen dhe nuk rezulton ende të ketë caktuar një datë për shqyrtimin e saj.

10. Pas kryerjes së veprimeve të para të verifikimit, duke pasur gjetjet e konstatuara dhe të parashtruara më lart, në bazë dhe për zbatim edhe të pikës 30 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, anëtarja e Këshillit relatore për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, ka vlerësuar se janë kushtet për të proceduar me dërgimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, pa qenë e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore. Prandaj, ka përgatitur relacionin mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe në datën 30.05.2019 e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

11. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 31.05.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e ndalimit të kandidimit të zotit Luan Dervishi, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

12. I njëjti njoftim, së bashku me materialet e çështjes i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

13. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 31.05.2019 dhe rendin e ditës janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

14. Për shkak të pamundësisë së shqyrtimit të çështjeve të përfshira në pikën e rendit të ditës lidhur me gjetjet në procedurat e verifikimit të kandidaturave, përfshirë atë të kandidatit Luan Dervishi, në mbledhjen e datës 31.05.2019, Këshilli vendosi shqyrtimin e tyre në mbledhjen e datës 05.06.2019.

15. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

16. Në thelb, Avokati i Popullit parashtrroi se; do të ishte me vend që Kolegji i Posaçëm i Apelit të kishte pasur në konsideratë detyrimin e KED për vendimmarrje në lidhje me personat të cilët e kanë përfunduar procesin e verifikimit në shkallë të parë. Ky proces është në dy shkallë dhe do të duhet që edhe organet e tjera të kenë vëmendjen e tyre për të ndihmuar në procesin e krijimit dhe të konstituimit të Gjykatës Kushtetuese, si edhe për të mos e cenuar vendimmarrjen e këtij Këshilli. Po kështu, edhe për të mos cenuar të drejtat e individëve të cilët nuk kanë një vendim të formës së prerë për tu përjashtuar nga sistemi gjyqësor. Nuk është e ndaluar kërkesa ose e drejta e këtij kandidati për tu zgjedhur vetëm për shkak të vendimit të shkallës së parë. Nga ana tjetër, ky kandidim për në Gjykatën Kushtetuese nuk është ngritje në detyrë brenda sistemit duke pasur parasysh se në kohën e pezullimit nuk mund të bëhet ngritje në detyrë. Kjo është një kërkesë me vete dhe Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit të karrierës brenda sistemit gjyqësor. Nëse kandidati do të rezultonte gjyqësor, në fazë të dytë, sigurisht që atij do ti ishte cenuar e drejta, që ai të ishte pjesë e kandidimit. Por, sigurisht ka edhe mundësi të tjera, mund ta provoje veten në vakanca e tjera. Për sa i përket gjetjes konkrete dhe propozimit të bërë nga ana e relatorit, është në përputhje me rregulloren e miratuar nga ky Këshill dhe në këtë gjendje të aktit, pra të rregullores, nuk mund të ketë ndonjë cenim të së drejtës së tij. Por në kuadër të një interpretimi më të gjerë kushtetues, mund të kishte një cenim të të drejtës së këtij personi për të vazhduar procedurën dhe për të pasur të drejtë për tu zgjedhur, duke qenë se nuk ka një vendim të formës së prerë për tu përjashtuar atë nga sistemi gjyqësor.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

17. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Luan Dervishi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

18. Në pikën 6 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se:

“6. Kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji.”.

19. Në nenin 62 të Ligjit nr. 84/2014 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, parashikohet se:

*“1. Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ex lege nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.
2. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje...”.*

20. Në shkronjën “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.”.

21. Në nenin 237 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se :

“Neni 237 Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

1. Jo më vonë se 35 ditë nga mbërritja e listave të kandidatëve dhe dokumenteve që i shoqëron ato, Këshilli për Emërimet në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore të parashikuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 234, pika 1, të këtij ligji.

2. Për këtë qëllim Këshilli dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës.

3. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit të kushteve ligjore, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit.”

22. Në pikën 30, 50, 51, 96 dhe 111 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, parashikohet se :

“30. Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.”

50. Në rastet e tjera, pas bisedimit dhe votimit të çështjes, Këshilli vendos:

a) lejimin e kandidimit;

b) ndalimin e kandidimit;

c) vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

51. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

a) deklaratimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati;

b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.”

96. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, rezulton se kandidati nuk plotëson ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të parashikuara, përkatësisht, nga neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000 për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese dhe nga neni 199 të ligjit nr. 115/2016 për kandidimet për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

111. Kandidatët magjistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk lejohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016.”.

23. Në interpretim dhe zbatim të drejtë të dispozitave të sipërcituara, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se vendimi i shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo prokurorit nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, megjithëse nuk ka marrë formën e prerë dhe është objekt shqyrtimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pas sjell efektet juridike të pezullimit nga detyra të subjektit të shkarkuar. Në këto raste efekti i pezullimit vjen nga konstatimet e shkeljes së ligjit dhe për rrjedhojë edhe të sanksionit kushtetues me natyrë disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve pas sjell vetvetiu edhe krijimin e një pengese ligjore për të kandiduar si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, kusht ky i parashikuar nga shkronja “d” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

24. Gjithashtu, në arritjen e këtij përfundimi, Këshilli mban parasysh në mënyrë sistematike disa parashikime kushtetuese dhe ligjore analoge dhe mbi të gjitha *ratio* normative e këtyre parashikimeve.

25. Kështu, në shkronjën “dh të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, parashikohet se një ndër kushtet ligjore për lejimin e kandidimit si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese është që kandidati të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

26. Nga ana tjetër, tashmë është krijuar një praktikë ligjore e tillë që ka ndaluar gjyqtarin dhe prokurorin e pezulluar nga detyra për shkak të shkarkimit të kandidojë për në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe të marrë pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë dhe prokurorë përkatës.

27. Së fundi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se duhet të mbahet parasysh edhe që Ligji nr. 96/2012 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e parashikon kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar nga ana e gjyqtarit apo prokurorit si kusht për ngritjen në detyrë.

28. Për rrjedhojë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se shkarkimi nga detyra i gjyqtarit apo i prokurorit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, edhe pse nuk ka marrë vendimi formë të prerë, krijon një pengesë ligjore për kandidimin si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

29. Në këto kushte Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se, pasi kandidati Luan Dervishi ka kërkuar të konkurojë për vendim vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, është krijuar një rrethanë që pamundëson zhvillimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit dhe ky Këshill duhet të vendosë ndalimin e kandidimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës; të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; (të) pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Luan Dervishi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Luan Dervishi.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
4. Kundër këtij vendimi mundet të ushtrohet ankim brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit.

KRYETARI

Ardian DVORANI

